



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 06
Prishtinë, më 21.03.2012, në orën 11.00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Rita Hajzeraj, Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Biserka Kostiq, Kymete Bajraktari, Kimete Bytyçi dhe Duda Balje.

Munguan: Justina Pula.

Pjesëmarrës të tjerë: Elita Vokshi-OSBE; Florije Mehmeti –KDI, Elizabeta Gjikkoda-KDI; Visar Bikliqi-NDI, praktikant; Sakibe Jashari- Ambasada zvicerane; Viosar Bivolaku- EU OFFICE; Nuredin Ibishi-CDF; Ukë Gashi-ZPRK dhe Burim Tahiri-praktikant.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinator dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novoberdali- kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 22 shkurt dhe 7 mars 2012;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i amendamenteve të dhëna në Projektligjin për persona të

verbër dhe personat pjesërisht të verbër;
4. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 22 shkurt dhe 7 mars 2012.

Albana Gashi- Duke u ndërlidhur me procesverbalet, tha se nëse ka mundësi procesverbalet mos të vonohen, por për çdo mbledhje t'i kemi të gatshme për miratim. Sa i përket raportit të Avokatit të Popullit, ajo tha se unë vetëm kam dhënë propozim që të ftohet Inspektorati Policor, nuk e di se a ka qenë e arsyeshme të jetë kjo në procesverbal.

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 22 shkurt dhe 7 mars 2012.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i amendamenteve të dhëna në Projektligjin për persona të verbër dhe personat pjesërisht të verbër

Kryetarja- Sa i përket këtij Projektligji, besoj se amendamentet e propozuara i keni marrë me kohë, dhe ndërkohë, ne kemi shkuar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Grupi i punës e di që është një propozim në nenin 7, që të ardhurat e tyre të jenë 70% të pagës minimale në Kosovë dhe kjo të jetë edhe për shoqëruesit e tyre, meqë në këtë Projektligj i kemi të ndarë dhe bëhet fjalë vetëm për kategorinë e personave të verbër, ndërsa këta persona ndahen në kategorinë e parë dhe të dytë. Kategoria e parë do t'i ketë shoqëruesit e tyre, ndërsa sa i përket numrit të përfituesve, Ministria nuk do të paraqesë problem, por ka disa probleme në vetë Projektligjin dhe ka mbetur që të bëhen disa propozime. Ne disa propozime i kemi inkorporuar, ndërsa disa ende nuk kemi arritur që t'i inkorporojmë, kështu që sot nuk do të kemi votimin përfundimtar, sepse duam të bëjmë një ligj funksional dhe të zbatueshëm. Kjo punë do të kryhet shumë shpejt, por ne, sot nuk mund t'i miratojmë pa i pasur të gjitha propozimet e inkorporuar. Sot, unë vetëm desha t'ju njoftoj me punën e deritashme, pra deri ku ka arritur.

Rita Hajzeraj – Duke u ndërlidhur me këtë, ajo tha se është mirë që ta dimë se çka do vijë si ndryshim nga Ministria, kur dihet se ky ligj është punuar nga Ministria, pra cili është qëllimi i këtyre ndryshimeve.

Kryetarja- Ministria e ka parë si të drejtë që këta persona nuk mund t'i kenë dy përfitime, për efekt verbërie dhe për efekt varfërie. Vetë shoqata ka pranuar që t'i heqë përfitimet për efekt varfërie dhe të mbetet vetëm për efekt verbërie, sepse nga kjo

përfitojnë edhe shoqëruesit e tyre. Këto ndryshime do t'i inkorporojmë dhe në mbledhjen e radhës dhe do t'i kemi për miratim, pra të gjitha paqartësitë kanë qenë në nenin 7 të Projektligjit.

4. Të ndryshme

Kryetarja- Njoftoi anëtarët e Komisionit me pyetësin e hartuar për monitorimin e Ligjit për Avokatin e Popullit. Ky pyetësor është bërë nga kryesuesja e grupit të punës, prandaj për informata më të hollësishme lus deputeten që të marrë fjalën.

Rita Hajzeraj- Ky pyetësor është bërë në pajtim me punën që është bërë edhe për monitorimet e ligjeve të tjera. Unë propozoj që të mbahet një dëgjim publik ditën e martë, më 27 mars 2012 dhe ky pyetësor të shpërndahej para mbajtjes së dëgjimit publik, ndërsa në këtë dëgjim publik të ftohen institucionet relevante që janë kompetente për zbatimin e këtij ligji, të cilat kanë lidhje ndërmjet veti.

Nëse dikush ka ndonjë propozim tjetër, ne mund të diskutojmë.

Biserka Kostiq- Duke u ndërlidhur me këtë pyetësor, tha se asaj i mungon pyetësori në gjuhën serbe.

Kryetarja – Ky pyetësor do të përkthehet shumë shpejt dhe do t'u dërgohet juve në gjuhën serbe.

Përfundim

Komisioni vendosi që të mbajë dëgjim publik për monitorimin e Ligjit për Avokatin e Popullit, më 27 mars 2012, në orën 13.00.

Kryetarja- Njoftoi anëtarët e Komisionit me peticionin e Vetëvendosjes dhe tha se ky peticion do të shqyrtohet në mbledhjen e radhës së Komisionit. Lidhur me këtë peticion, është kërkuar debat parlamentar, sepse janë mbledhur mbi 13.000 mijë nënshkrime lidhur me fusnotën për të cilën keni njohuri të gjithë.

Kryetarja- Gjithashtu, njoftoi se më 28 mars në orën 10.00, Komisioni do të ketë një vizitë në Shtëpinë e Pleqve në Prishtinë, ku do të shohim për së afërmi se çfarë kushtesh kanë ata, çfarë kujdesi u ofrohet dhe a plotësohen kushtet e nevojshme për ata persona. Gjithashtu, ajo njoftoi se sot në orën 13.00 do të kemi tryezë të rrumbullakët lidhur me pikën 52 të Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritet evropian.

Kimete Bytyçi- Propozoi që herëve të tjera mos të jenë dy aktivitete brenda ditës, sepse kemi edhe angazhime të tjera dhe jemi shumë të ngarkuar.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdali